



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.10.2021

MBLEDHJA Nr. 47,
datë 04.10.2021, ora 16:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 04.10.2021, ora 16:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 47 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “Hec Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a., nr. 914, datë 02.09.2021
3. Mbi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a., nr. 925, datë 07.09.2021
4. Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 190, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 248, seria PV14K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hydropowerplant Construction” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 06.10.2014”, i ndryshuar dhe përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 191, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 253, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hydropowerplant Construction” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 102, datë 07.11.2014, i ndryshuar
5. Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 189, datë 10.09.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 7, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Sarolli” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 27.08.2003
6. Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e ERE-s nr.60, datë 25.02.2021, “Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”
7. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI